

## Mbrojtja e fshatrave, fermave dhe aseteve të tjera rurale nga zjarri.

---



### PJESA I

Udhëzime për autoritetet lokale dhe për drejtuesit e njësive të qeverisë vendore.

© Qendra Globale e Monitorimit të Zjarreve 2013  
Botuar nga Shtëpia Botuese Kessel  
Eifelweg 37  
53424 Remagen-Oberëinter  
Germany  
Tel: +49-2228-493  
Fax: +49-3212-1024877  
Email: [webmaster@forstbuch.de](mailto:webmaster@forstbuch.de)  
Internet: [www.forestrybooks.com](http://www.forestrybooks.com)  
Botuar në Gjermani  
[www.business-copy.com](http://www.business-copy.com)

Ky udhëzues është përgatitur nga EUROFIRE në kuadrin e ***Trainimit Rajonal për Menaxhimin e Zjarrit*** për Kaukazin Jugor dhe Ballkanin Perëndimor

Antalya, Turqi, 15-17 Tetor 2014

---

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë medeomos mendimet e OSBE-së dhe donatorit të tyre.

Përkthimi nga:



### Autorët kryesorë

Johann Georg Goldammer, Qendra Globale e Monitorimit të Zjarreve (GFMC)

Ioannis Mitsopoulos, Qendra Globale e Monitorimit të Zjarreve (GFMC)

Oyunsanaa Byambasuren, Qendra Globale e Monitorimit të Zjarreve (GFMC)

Pete Sheldon, Qendra Globale e Monitorimit të Zjarreve (GFMC)

### Falënderime

Në këtë botim kanë dhënë kontribut të çmuar një sërë ekspertësh, duke përfshirë:

**Nikola Nikolov**, Qendra Globale e Monitorimit të Zjarreve, FYROM

**Sergiy Zibtsev**, Qendra Rajonale e Monitorimit të Zjarreve në Evropën Lindore, Ukrainë

**Alex Dimitrakopoulos**, Universiteti Aristotel I Selanikut, Greqi

**Gavriil Xanthopoulos**, Organizata Bujqësore Greke “DEMETRA”, Greqi

**Erturgul Bilgili**, Universiteti Teknik Karadeniz, Turqi

**Andrey Eritsov**, Qendra e Kontrollit nga Ajri të Zjarreve të Pyjeve *Avialesookhrana*, Federata Ruse

**Chrisilios Chrysiliou**, Mbrojtja Civile e Qipros, Qipro

**Goran Videc**, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Administrimit të Pyjeve dhe Ujërave, Drejtoria e Pyjeve, Kroaci

**Milt Statheropoulos**, Qendra Evropiane e Zjarreve të Pyjeve, Greqi

**Sofia Karma**, Qendra Evropiane e Zjarreve të Pyjeve, Greqi

### Foto dhe Ilustrime

Foto në Pjesën 1:

**Nikolas Giakoumidis**, Athinë, Greqi (f. 3, 5, 7, 8)

**Gavriil Xanthopoulos**, Athinë, Greqi (f. 6, 9)

Ilustrime në Pjesën 2:

**Manina Dourali**, Groovy Graphics X @2011, Athinë, Greqi.

Falënderime të veçanta i shkojnë **Fondacionit Maria Tsakos**, Ishulli Kios, Greqi për bashkëfinancimin e projektit.

*Opinionet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.*

## Parathënie

Në disa rajone të vendbanimeve rurale të Evropës (fshatra, qytete, ferma të shpërndara), asetet rurale (fusha bujqësore, infrastruktura rurale dhe vlera të tjera të rrezikuara) po rrezikohen gjithmonë e më shumë nga zjarri. Kjo tendencë përforcohet edhe nga pasojat e ndryshimit të përdorimit të tokës, ndryshimi i klimës rajonale dhe, sidomos, nga eksodi rural, i cili ka rezultuar në dobësimin e forcës së punës në fshat dhe të aftësisë për t'u vetëmbrojtur, duke rritur rreziqet nga zjarri që u kanosen tokave të braktisura.

Po kështu, industrializimi dhe përqendrimi i popullsisë në disa zona ushtrojnë një presion të lartë mbi burimet natyrore për ndryshimin e përdorimit të tokës, i cili pasqyrohet në rastet e shpeshta të zjarrvënies së qëllimshme dhe të rënies së zjarreve për arsye "të panjohura" në zonat me bimësi të egër.

Përzierja e vendbanimeve të njeriut me ekosistemet natyrore dhe zjarret që bien në kufirin midis pyjeve të egra dhe vendbanimeve rurale krijojnë në shumë vende probleme serioze, të cilat janë shndërruar në një çështje madhore debati dhe konfrontimi politik.

Fatkeqësitë e kohëve të fundit nga zjarri në Evropë tregojnë se autoritetet qeveritare dhe shoqëria civile, sidomos komunitetet rurale, nuk janë të përgatitura sa duhet për të parandaluar dhe për të reduktuar rrezikun nga zjarri, për të mbrojtur komunitetet rurale dhe asetet rurale të rrezikuara, si dhe për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe sigurinë në përgjithësi nga pasojat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të zjarreve.

Këto udhëzime u ofrojnë banorëve (fermerëve, drejtuesve të komuniteteve, zjarrfikësve vullnetarë dhe komiteteve të mbrojtjes së fshatrave) informacionet më të fundit mbi masat parandaluese të dëmtimeve nga zjarri dhe masat pragmatike për mbrojtjen e vendbanimeve dhe asetëve të tjera të çmuara rurale nga zjarri. Me këto udhëzime, komunitetet do të jenë në gjendje të vënë në zbatim të gjitha rregulloret e sigurisë për mbrojtjen e strukturave të komunitetit (pastrimin e bimësisë, ofrimin e burimeve të tjera shtesë të ujit, aplikimin e kodeve të duhura të ndërtesave dhe përdorimin e materialeve të duhura, etj.) dhe për mbrojtjen e popullatave rurale nga pasojat negative të ndotjes së bimësisë nga zjarri dhe tymi mbi shëndetin dhe sigurinë e njeriut. Gjithashtu, problemi i zjarreve në terrene të ndryshuara nga aktiviteti i njeriut, si zjarret që prekin struktura të shpërndara dhe ndonjëherë të braktisura, vend-depozitime plehrash dhe toka të kontaminuara, duhet të adresohen për shkak të emetimeve tejet toksike që gjeneron djegia e bimësisë natyrore dhe produkteve teknike/kimike.

Përveç kësaj, duhet të adresohen edhe kërcënimet që vijnë nga zjarret që bien në territore të kontaminuara nga mjetet e pashpërthyer vrasëse, duke qenë se disa toka pyjore dhe jopyjore në rajonin e Ballkanit janë të kontaminuara nga minat dhe mjete të pashpërthyer vrasëse që kanë mbetur nga konfliktet e kohëve të fundit.

Për të rritur aftësitë e komuniteteve lokale rurale për t'u mbrojtur nga zjarret, është hartuar një paletë udhëzimesh me qëllim që:

- Të ofrojë një dokument teknik praktik të projektuar si një mjet mbështetës për mbrojtjen e njerëzve dhe komuniteteve lokale rurale në rajonin e Ballkanit nga zjarret
- Të shërbejë si pikënisje dhe bazë për shkëmbimin e ekspertizës dhe koncepteve brendapërbrenda shteteve anëtare të Këshillit të Evropës/UNECE për të zgjeruar vazhdimisht kapacitetet për menaxhimin e zjarreve rurale.

Këto udhëzime janë përgatitur me mbështetjen e Marrëveshjes Evropiane dhe Mesdhetare për Rreziqet Madhore (EUR-OPA) krijuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës. Qendrat që bashkëpunojnë në këtë kuadër janë Qendra Evropiane e Zjarreve të Pyjeve (Athinë), Qendra Globale e Monitorimit të Zjarreve (Gjermani), Qendra Rajonale e Monitorimit të Zjarreve në Evropën Juglindore/Kaukaz (Shkup) dhe Qendra Evropiano-Lindore e Monitorimit të Zjarreve (Kiev). Në hartimin e udhëzimeve kanë kontribuar edhe anëtarët e Ekipit të Specialistëve të UNECE/FAO-s për Zjarret e Pyjeve.

Udhëzimet ndahen në dy pjesë:

Pjesa 1: Udhëzime për Drejtuesit e Njësive të Qeverisë Vendore

Pjesa 2: Udhëzime për Komunitetet dhe Popullatat Lokale

Në shkurt të 2013-ës, koncepti i udhëzimeve u testua në një fushatë të zhvilluar në Ishullin Kios në Greqi, organizuar nga GFMC-ja dhe Fondacioni Maria Tsakos. Kjo fushatë kishte për qëllim të shqyrtonte ekspozimin, përvojat dhe pikëpamjet e popullatës lokale para, gjatë dhe pas zjarreve. Gjatë fushatës u zhvilluan intervista me 118 banorë vendas në zonat e prekura nga zjarret e mëdhenj të gushtit 2012. Rezultatet e fushatës mund të merren duke i drejtuar një kërkesë GFMC-së.

## **Pasqyra e lëndës**

<b>Konteksti.....</b>	<b>8</b>
<b>2. Disa fakte rreth kërcënimeve nga zjarri .....</b>	<b>10</b>
2.1 Kërcënimi nga Zjarri i Shoqërisë.....	10
2.2 Shkaqet e zjarreve .....	16
<b>2.3 Faktorët që ndikojnë në ecurinë e zjarreve.....</b>	<b>18</b>
2.4 Probleme specifike: Zjarret në tokat e kontaminuara .....	20
<b>3. Përgatitja për Zjarret .....</b>	<b>20</b>
3.1 Mbledhja e aktorëve të interesuar dhe e vendimmarrësve .....	21
3.2 Plani i Mbrojtjes së Komunitetit nga Zjarret .....	21
3.3 Realizimi i Parandalimit dhe Përgatitjes në Nivel Komuniteti .....	23

**Mbrojtja e fshatrave, fermave dhe aseteve të tjera rurale nga zjarri:**

**PJESA 1**

**UDHËZIME PËR AUTORITETET E NJËSIVE TË QEVERISË VENDORE**

## Konteksti

Në të gjithë Gadishullin e Ballkanit dhe ishujt përreth tij që gjenden në Detin Egje, Detin Jon dhe në Detin Adriatik, fshatrat, qytetet, fermat bujqësore dhe blegtorale dhe asete të tjera rurale, si fushat e të mbjellave, infrastruktura dhe vlera të tjera po rrezikohen gjithmonë e më shumë nga zjarri. Ky kërcënim gjithmonë e më i madh është pasojë e:

- Migrimit të brendshëm të popullsisë rurale në qendrat urbane, i cili ka çuar në uljen e krahut të punës në fshat dhe, si pasojë, në një aftësi më të vogël për t'u vetëmbrojtur nga zjarri
- Ndryshimeve të përdorimit të tokës nga braktisja e tokave bujqësore dhe kullotave, gjë që ka çuar në dëmtimin e bimësisë natyrore (shkurreve, pemëve, etj.) dhe në një akumulim të madh të lëndës djegëse natyrore.
- Praktikave më pak intensive të menaxhimit të pyjeve (prerje, mbledhje rrëshire, ndërtim rrugësh, etj.) dhe më pak mbledhje drush zjarri nga pyjet si rezultat i reduktimit të popullsisë rurale dhe vendimeve ekonomike
- Ndryshimeve të klimës rajonale karakterizuar nga temperatura të larta në verë dhe episode të gjata thatësire dhe reduktim reshesh gjatë vitit

Urbanizimi i pjesëve të mëdha të popullatës rurale dhe përqendrimi i industrisë në qendrat urbane kanë krijuar një kërkesë të lartë për strehim dhe për zhvillimin e zonave industriale dhe, si rrjedhojë, kanë krijuar presion për t'i përdorur për të tjera qëllime tokat e mbuluara me bimësi në vijën ndarëse mes zonave rurale dhe atyre urbane. Kjo tendencë është pasqyruar edhe në rritjen e rasteve të zjarrvënies së qëllimshme në këto zona.

Përzierja e vendbanimeve të njeriut me ekosistemet natyrore dhe zjarret në vijën që ndan pyjet nga vendbanimet rurale dhe, në disa raste, në zonat gjysmë-urbane të qyteteve të mëdha krijon në shumë vende probleme serioze, të cilat janë shndërruar në qendrën e debateve dhe përplasjeve politike.

Fatkeqësitë e kohëve të fundit nga zjarret në Rajonin e Ballkanit treguan se autoritetet qeveritare dhe shoqëria civile, sidomos komunitetet rurale, nuk janë të përgatitura sa duhet për të parandaluar dhe për të reduktuar rrezikun nga zjarret, për të mbrojtur komunitetet rurale dhe asetet rurale të rrezikuara dhe për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe sigurinë nga pasojat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të zjarreve.

Këto udhëzime u ofrojnë informacion drejtuesve të komuniteteve lokale, njësive zjarrfikëse lokale, zjarrfikësve vullnetarë dhe komiteteve të mbrojtjes së fshatrave rreth nevojës së bashkëpunimit me banorët vendas për marrjen e masave efikente për:

- Parandalimin e zjarreve;



- Përgatitjen për situata emergjence në rast zjarri, duke përfshirë edhe incidentet e zjarreve të mëdhenj;
- Mbrojtjen e vendbanimeve dhe aseteve rurale nga zjarri.

Drejtuesit e Komuniteteve Lokale (Kryetarët e Bashkive ose Kryetarët e Njësive Administratave Lokale) dhe Drejtuesit e Shërbimeve Publike në Bashki apo nivel qarku, duhet t'i informojnë menjëherë banorët që jetojnë në fshatra apo ferma të shpërndara bujqësore rreth kërcënimeve nga zjarret dhe për mënyrat se si ata mund të mbrojnë veten dhe pronën e tyre.

Këto udhëzime kanë për qëllim t'i informojnë dhe t'u japin mundësi anëtareve të komuniteteve lokale që të vënë në jetë disa rregullore bazë të sigurisë ndaj zjarrit për mbrojtjen e pronave dhe, ajo çka është më e rëndësishme, për mbrojtjen e familjeve të tyre nga pasojat e drejtpërdrejta apo të tërthorta (p.sh. pasojat e ndotjes nga tymi i zjarrit mbi shëndetin dhe sigurinë e banorëve dhe zjarrfikësve) të zjarrit.

Problemi i zjarreve që bien në toka natyrore që përdoren si vend-depozitime mbetjesh apo që janë të kontaminuara nga mbetjet industriale duhet të adresohet për shkak të emetimeve të larta toksike që prodhohen nga djegia në të njëjtën kohë e bimësisë natyrore dhe nënprodukteve kimike.

Përveç kësaj, duhet të adresohen gjithashtu edhe kërcënimet që vijnë nga zjarret që bien në territore të kontaminuara nga mjetet mjetet e pashpërthyera vrasëse, duke qenë se disa toka pyjore dhe jopyjore në Rajonin e Ballkanit janë të kontaminuara nga minat dhe nga mjete të pashpërthyera vrasëse që kanë mbetur si pasojë e konflikteve të armatosura të kohëve të fundit.

Bashkë me këto Udhëzime ofrohet edhe një paketë e dytë materialesh ilustruese, e cila duhet t'u shpërndahet pronarëve të shtëpive, fermave dhe bizneseve rurale. Përmes këtyre materialeve ilustruese, banorët do të ndërgjegjësohen rreth kërcënimeve që përbëjnë zjarret për sigurinë dhe shëndetin e familjeve të tyre, kërcënimet ndaj pronës private dhe infrastrukturës publike dhe do të mësojnë se si t'i reduktojnë apo t'i zbusin këto kërcënime potenciale.

## 2. Disa fakte rreth kërcënimeve nga zjarri

### 2.1 Kërcënimi nga Zjarri i Shoqërisë

Shumë shtëpi, struktura dhe asete të tjera rurale, si makineri dhe të mbjella, janë të shpërndara nëpër pyje, toka natyrore, toka bujqësore dhe kullota. Kështu, mes peizazheve që mund të marrin lehtë flakë dhe pronave rurale ka shumë zona ndërveprimi. Kjo zonë kontakti midis peizazhit natyror dhe strukturave dhe asetëve njerëzore e rrit rrezikun nga zjarret katastrofike që kërcënojnë jetën, pronën dhe infrastrukturën e mijëra komuniteteve. Lufta ndaj zjarreve në këtë zonë mund të komplikohet, mund të jetë e kushtueshme dhe e rrezikshme për shkak të situatave të panjohura me të cilat mund të përballen zjarrfikësit dhe civilët. Përveç pasojave të zjarreve mbi mjedisin natyror, kërcënimet kryesore të zjarreve ndaj komuniteteve rurale janë:

- Humbja e jetës dhe pasojat negative mbi shëndetin për shkak të nxehtësisë dhe tymit;
- Humbja e pronave dhe asetëve private dhe publike;
- Dëmtimi dhe humbja e prodhimit bujqësor dhe bagëtisë;
- Shkatërrimi i pyjeve;
- Pasojat negative mbi sektorin e turizmit.

Përveç komuniteteve rurale, zjarret kërcënojnë edhe periferitë e qyteteve të vogla e madje edhe atyre të mëdha.

Marrë së bashku, pasojat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të zjarreve mbi jetën dhe pronën e shoqërisë dhe humbjet financiare mund të jenë më të larta dhe shumë joproportionale me dëmet e shkaktuara ndaj ekosistemeve natyrore, sidomos po të kemi parasysh se shumë ekosisteme në Mesdheun Lindor dhe Evropën Juglindore mund të rikuperohen vetvetiu pas zjarrit.

#### Pasojat në njerëz

- Vdekjet apo lëndimet e shkaktuara nga zjarri janë një rrezik që u kanoset si zjarrfikësve, ashtu edhe civilëve;
- Zjarret përhapen shpesh shumë shpejt dhe në mënyrë të paparashikueshme
- Njerëzit mund të ngecin mes flakëve dhe të vuajnë nga djegiet direkte;
- Thithja e tymit të zjarrit mund të prekë sistemin e frymëmarrjes të njeriut. Kështu, shumë njerëz mund të mbyten nga tymi kur luftojnë me zjarrin ose kur përpiqen t'i largohen;
- Zjarret mund të shkaktojnë viktima ndër zjarrfikësit profesionistë dhe ata vullnetarë për shkak të pafuqisë nga nxehtësia, thithja e tymit dhe stresi që pëson trupi në një situatë zjarri;
- Pafuqia nga nxehtësia dhe stresi, kombinuar me funksionimin e mjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse mund të çojë në aksidente;
- Edhe dëmtimet e vogla në këto rrethana mund të çojnë në humbjen e jetës;

- Ndikimi i ndotjes nga tymi në shëndetin e njeriut mund të prekë zjarrfikësit dhe njerëzit afër zjarreve, por edhe njerëzit që jetojnë në zona larg zjarreve. Thithja e tymit të zjarrit ka pasoja të rrezikshme për shëndetin e njeriut.
- Tym i zjarrit është një përzierje komplekse e gazrave dhe substancave të rrezikshme për shëndetin e njeriut;
- Thithja e tymit të zjarrit mund të shkaktojë një sërë pasojash akute, afatshkurtra apo afatgjata;
- Simptomat variojnë nga dhimbjet e kokës dhe dhimbjet e syve dhe fytit si pasojë e ekspozimit të shkurtër ndaj tymit deri te gjendja e të fikëtit shoqëruar nga probleme të frymëmarrjes dhe zemrës;
- Pasojat negative të thithjes së tymit keqësohen nëse viktimat vuan prej kohësh nga astma, nga ndonjë alergji, apo nga ndonjë sëmundje zemre. Në këto raste, thithja e tymit mund të rezultojë fatale;
- Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar zjarreve në terrene ku ka ende mjete të pashpërthyera vrasëse dhe mina nga konflikte të mëparshme të armatosura. Këto zjarre kanë rezultuar në mënyrë të përsëritur në vdekje dhe plagosje (shih Pjesën 2.4).



### Humbja e pronës

Shtëpitë, fermat dhe komunitetet lokale rurale kërcënohen që të gjitha nga zjarri në dy mënyra:

- Dëmtimet e drejtpërdrejta kur flakët ose nxehtësia rrezatuese çon në shkëndija në strukturat ngjitur;

- Transportimi i thëngjijve nga era në distanca të mëdha, duke u depozituar në majat e çative dhe madje edhe brenda shtëpive, duke i vënë flakën pjesës së djegshme të strukturës, si mobilje, perde, etj.

Një faktor i rëndësishëm që mund të çojë në humbjen e pronës është masa në të cilën mund ta marrin flakë materialet me të cilat janë ndërtuar godinat:

- Në fshatra, ku shtëpitë zakonisht bëhen prej druri apo prej materialesh të improvizuara, humbjet nga zjarri mund të shkojnë shpesh deri në qindra struktura që digjen nga një zjarr i vetëm
- Në të kundërt, kur shtëpitë janë prej materialesh që nuk marrin flakë, si guri, tulla, betoni, humbjet janë shumë më të vogla.



Humbjet ekonomike nga zjarri përfshijnë si dëmet në prona private, ashtu edhe ato në prona publike. Përveç shkatërrimit të thellë të shtëpive dhe infrastrukturës, në rajonin e Ballkanit janë shënuar këto dëme të tjera madhore:

- Humbja e të korrave të vitit për shkak të zjarreve mund të jetë shumë e madhe, sidomos kur zjarret ndodhin pikërisht para sezonit të korrjes. Në fakt, janë raportuar edhe zjarre të shkaktuar nga shkëndijat që lëshojnë makineritë korrëse.
- Shkatërrimi i kulturave shumëvjeçare si ullishtet, plantacionet e frutave apo pemishteve me rrëshirë janë ë të rëndësishme nga pikëpamja ekonomike për shkak të kohës që është dashur për krijimin e tyre, një proces që kërkon zakonisht vite të tëra;
- Tymi i zjarreve të mëdha i depozituar në vreshta ndikon te cilësia e verës, pasi çon në prodhimin e një vere me ‘aromë tymi’, duke ia ulur kështu cilësinë dhe vlerën komerciale. Përveç kësaj, efekti i hirit të depozituar në dhe është një problem që vazhdon për vite me radhë;

- Një rast i veçantë është shkatërrimi i serrave dhe infrastrukturave të tjera (p.sh. rrjetet e ujitjes), të cilat përbëjnë një humbje të konsiderueshme kapitale, nga e cila fermerët e kanë të vështirë ta marrin veten; te tjera humbje përfshijnë gardhet dhe ndërtesat e tjera për qëllime bujqësore;
- Humbje bagëtish mund të ndodhin në kullota të hapura, livadhe, vathë dhe stalla;
- kabllot dhe shtyllat telefonike dhe elektrike mund të dëmtohen nga zjarri, duke shkaktuar kështu ndërprerjen e komunikimit dhe të furnizimit me energji elektrike. Përveç kësaj, riparimi i tyre kushton shtrenjtë.



### **Humbje të produkteve pyjore**

Humbjet e konsiderueshme ekonomike në pyje përfshijnë humbjen e produkteve pyjore, p.sh.:

- Lëndën e drurit: Shkalla e dëmit varet nga lloji i drurit (sipërfaqja, kurora, përzierja e të dyjave) dhe nga përmasat e zjarrit, nga pozicionimi dhe nga karakteristikat e pemëve të zonave të djegura pyjore dhe qëllimi për të cilin ato synohen të përdoren (shtylla, lëndë druri, copëza për prodhim kompensate, etj.)
- Dru zjarri ose lëndë e parë drusore për energji të rinovueshme (peletë)
- Produkte pyjore jodrusore si rrëshira, frat, bimët medicinale.



## Turizmi

Zjarret kanë shpesh pasoja shkatërruese dhe të kushtueshme për turizmin vendas. Evakuimi i turistëve nga kampet apo akomodimet e tjera janë të rrezikshme dhe me kosto. Imazhi negativ që transmetohet nga zonat turistike të prekura apo të rrezikuara nga zjarri çojnë shpesh në anulimin e rezervimeve për një kohë të shkurtër. Efektet e zjarreve për zonat turistike janë shumë të dëmshme dhe mund të zgjasin me vite. Kështu, është në interesin e autoriteteve lokale që të marrin masa paraprake për të garantuar sigurinë e vizitorëve dhe për të shmangur humbjet afatgjata të të ardhurave në zonat turistike të prekura nga zjarri.



### **Humbjet e vlerave pyjore dhe vlerave të patregtueshme**

Komunitetet dhe qeveritë vendore kanë një detyrim të rëndësishëm etik për të kontribuar në mbrojtjen e aseteve të përbashkëta globale si biodiversiteti dhe izolimi i karbonit:

- Biodiversiteti: Zjarret shkaktojnë shpesh humbje të rënda të biodiversitetit, sidomos në ekosistemet e ndjeshme ndaj zjarrit
- Humbja e karbonit: Politikat aktuale ndërkombëtare nxisin izolimin e karbonit nga pyjet në përpjekje për të luftuar efektin serrë. Ato u japin vendeve një motiv për të rritur sipërfaqet e pyllëzuara, duke përfshirë edhe subvencione monetare sipas Protokollit të Kiotos. Zjarret e pyjeve çlirojnë karbon në atmosferë kryesisht në formën e dioksidit të karbonit dhe kjo përkthehet direkt në humbje monetare.

### **Ndikime të tjera dytësore**

Ndikimet e konsiderueshme dytësore të zjarreve shkaktohen nga shkatërimi i bimësisë sipërfaqësore dhe shtresave të dheut, të cilat janë të rëndësishme për mbrojtjen e tokës nga erozioni, sidomos në zonat malore. Disa zjarre të rënda që e dëmtojnë tokën aq sa të mos mund të mbajë bimësi mund të çojnë në:

- Rritje të erozionit dhe humbje të tokës pjellore dhe produktive
- Rrëshqitje të tokës, duke kërcënuar strukturat dhe infrastrukturat (duke përfshirë edhe rrugët) e madje edhe jetën e njeriut
- Krijimin e përmytjeve shumë të shpejta (përmytje të befasishme), të cilat janë më të rrezikshmet për zonat e banuara dhe për sigurinë e njerëzve.

Ndikime të tjera sekondare vijnë nga djegia e strukturave, infrastrukturave dhe “trashëgimisë së industrializimit”, d.m.th. vende ku hidhen mbeturinat dhe vendet e tjera të hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve industriale. Strukturat, bizneset dhe vend-depozitimet e mbeturinave përmbajnë mbetje familjare, pajisje elektrike, materiale sintetike dhe industriale, duke përfshirë edhe bateri e madje edhe materiale radioaktive. Djegia e këtyre materialeve prodhon sasi të konsiderueshme ndotësish të ajrit, të cilët janë jashtëzakonisht të rrezikshëm për shëndetin e njeriut.



## 2.2 Shkaqet e zjarreve

Sipas të dhënave statistikore, më shumë se 98 përqind e zjarreve në rajonin e Ballkanit shkaktohen nga aktivitetet e njeriut. Shumica e zjarreve vijnë nga neglizhenca dhe nga përdorimi i zjarrit si mjet në praktikat bujqësore. Shumë shpesh, praktikat bujqësore të djegies konsiderohen si traditë, por ditët e sotme, zjarre të tilla në shumë vende janë në kundërshtim me ligjin. Shembujt e shkaqeve të zjarreve më poshtë përfshijnë edhe përdorimet dhe burimet e zjarreve, të cilat janë shumë të shpeshta edhe në këtë rajon.

Më poshtë, administratat e komuniteteve lokale këshillohen për mënyrat se si mund ta reduktojnë numrin dhe pasojat e zjarreve të shkaktuara nga njerëzit.

### **Djegiet bujqësore**

Përdorimi i zjarrit në sektorin e bujqësisë është një praktikë e njohur në të gjitha Evropën Lindore dhe Jug-Lindore. Zjarri përdoret kryesisht për:



- Pastrimin e kulturave bujqësore nga të korrat ose për tëharrjen e mbetjeve dhe për djegjen e kashtës;
- Përmirësimin e cilësisë së tokave të kullotave.

Shumë shpesh, këto zjarre nuk administrohen siç duhet. Ndonëse zjarret bujqësore janë shpallur të paligjshme në shumë vende, shumë fermerë i vënë zjarret dhe largohen menjëherë nga vendi i zjarrit për të mos u arrestuar nga policia. Kjo është një nga arsyet kryesore të daljes shpesh jashtë kontrollit të zjarreve të qëllimshme dhe përhapjes së tyre deri në pyje dhe në zona të banuara.

*Në nivel lokal duhet të mbahen rregullisht diskutime në tryeza të rrumbullakëta për t'i informuar përdoruesit lokalë të tokave dhe pronarët e ndërtesave rreth anës juridike të përdorimit të zjarreve; për rreziqet që shoqërojnë zjarret e paligjshme apo për mosrespektimin e ligjeve dhe rregulloreve; Duhet të propozohen udhëzime për zëvendësimin e zjarreve tradicionale me metoda të tjera për arritjen e të njëjtave qëllime (pastrimin e fushave bujqësore, përmirësimin e kullotave) në mënyrë më të sigurt.*

### **Vendet e grumbullimit të mbeturinave dhe vende të tjera mbetjesh**

Vendet e grumbullimit të mbeturinave përbëjnë një burim të konsiderueshëm zjarresh që përhapen nga:

- Djegia spontane e mbetjeve fermentuese që prodhojnë metan;
- Mbeturinave u vihet shpesh zjarri për të reduktuar volumin e tyre dhe për të zgjeruar sipërfaqen ku mund të depozitohen mbetje të tjera;
- Mbetjetet familjare dhe mbetjetet e kopshteve të shtëpive, të cilat digjen në komunitetet, ku nuk ka shërbime të grumbullimit të mbetjeve, për shkak të mungesës së alternativave.

*Menaxhimi i vendeve të mbyllura apo të hapura të depozitimit të mbetjeve duhet të trajtohet me prioritet me qëllim respektimin e rregullimeve ligjore dhe mjedisore, duke përfshirë edhe parandalimin e vetëndezjes apo të ndezjes së zjarreve nga njerëzit. Në nivel lokal duhet të zhvillohen rregullisht diskutime për t'i informuar banorët se djegia e mbetjeve në pronat e tyre private është e paligjshme, sepse ajo përbën një rrezik të lartë zjarresh dhe prodhon ndotës toksikë të ajrit.*

### **Trafiku rrugor dhe hekurudhor, makineritë bujqësore dhe pyjore**

Trafiku rrugor dhe hekurudhor përbën një burim të konsiderueshëm zjarrvënieje. Shkëndijat nga frenat e trenave apo nxehtësia nga sistemet e shkarkimit të gazrave të makinave dhe konverterat e tyre katalitike mund t'i vënë zjarrin lëndëve të thata djegëse.

Makineritë bujqësore dhe pyjore janë në kontakt të ngushtë me materialet e djegshme dhe përbëjnë një burim të rëndësishëm zjarri. Bishtat e cigareve të hedhura rrugëve janë një burim i zakonshëm zjarri.

*Autoritetet lokale në bashkëpunim me agjencitë qeveritare apo kompanitë private duhet të bashkëpunojnë për reduktimin e materialeve të djegshme nëpër rrugë apo shina hekurudhash me qëllim uljen e potencialit për të shkaktuar një zjarr. Kjo do të kërkonte punësimin sistematik të punëtorëve lokalë për pastrimin e bimësisë së tharë, për krasitjen e pemëve dhe për krijimin e zonave të hapura dhe të aksesueshme me më pak pemë, shkurre dhe bar. Kompanitë hekurudhore duhet të mbajnë përgjegjësi nëse nuk përdorin materialet e duhura për frenimin për të minimizuar prodhimin e shkëndijave.*

### **Linjat e energjisë elektrike**

Linjat e energjisë elektrike përbëjnë një burim të zakonshëm zjarresh. Erërat e forta mund të shkaktojnë harqe elektrike dhe qarqe të shkurtra mes linjave të varura, duke shkaktuar në këtë mënyrë krijimin e shkëndijave që mund t'u vënë flakën lëndëve të djegshme të thata dhe të imëta kur bien në tokë. Edhe izolantët që nuk pastrohen dhe që nuk mirëmbahen siç duhet mund të shkaktojnë prodhimin e harqeve në ditë me lagështi. Linjat e energjisë elektrike që rrëzohen prej erërave të forta apo mosmirëmbajtjes siç duhet të shtyllave elektrike mund të prodhojnë shkëndija elektrike. Zjarret në kushtet e erërave të forta mund të përhapen dhe të zmadhohen shumë shpejt.

*Është absolutisht e nevojshme që të pastrohet menjëherë bimësia poshtë tyre dhe në një distancë prej të paktën 10 m nga linjat elektrike. Megjithëse kjo detyrë i takon kompanisë së energjisë elektrike, autoritetet lokale duhet të kërkojnë që të bashkëpunojnë me kompaninë në mënyrë që ta kontrollojnë dhe ta mirëmbajnë pa bimësi brezin në të cilin shtrihet linja.*

### **Zjarrvënia e qëllimshme**

Zjarrvënia e qëllimshme përbën shkakun kryesor të zjarreve në Ballkan. Ndonjëherë, zjarri vihet me qëllim fshehjen e prerjeve të paligjshme të pyjeve, për të fshehur kultivimin e paligjshëm të drogës ose për të krijuar pyje të djegura, në të cilat normalisht nuk lejohet prerja e pemëve, përveç atyre që mund të shpëtojnë pas zjarrit. Në disa raste, zjarret vihen me qëllim pastrimin e pyjeve dhe të bimësive të tjera natyrore, duke rritur kështu shkëlqjen e zonave të djegura pyjore publike për ndryshimin e përdorimit më vonë të tokës (strehim, bujqësi, etj.)

*Duhet të organizohen diskutime në tryeza të rrumbullakëta lokale në nivel komuniteti për të informuar pronarët e tokave se cenimi dhe ndryshimi më vonë i përdorimit të tokave të pyjeve të djegura publike janë të paligjshme edhe pse bimësia pyjore në këto zona është shkatërruar.*

## **2.3 Faktorët që ndikojnë në ecurinë e zjarreve**

Janë tre faktorë kryesorë që ndikojnë në ecurinë e zjarrit. Sasia dhe karakteristikat e materialeve të djegshme të bimësisë, moti dhe topografia.

### **Materialet e djegshme bimore**

Lëndët djegëse organike – të gjalla (të gjelbra) apo pa jetë – janë të djegshme dhe mund ta transportojnë zjarrin nga një vend në tjetrin:

- **Pyjet:** gjethet, halat, degët e pemëve, barishtet, bari i thatë dhe mbeturinat e hedhura në tokë
- **Zonat bujqësore dhe kullotat:** Mbetjet bujqësore, kashta, bari i thatë dhe i pakositur, si dhe shkurre e pemë të ndryshme.

Ka disa parametra të materialeve të djegshme organike që përcaktojnë se si zhvillohet zjarri

- **Përmasat e grimcave të materialeve të djegshme:** gjethet e vogla, degët dhe bari digjen më lehtë
- **Niveli i lagështisë:** Niveli i lagështisë apo thatësisë së materialeve të djegshme organike përcaktohet nga
  - *Temperatura e ajrit:* Temperaturat e larta e përshpejtojnë tharjen dhe aftësinë djegëse të materialeve organike. Ato mund ta arrijnë temperaturën e ndezjes me më pak energji
  - *Niveli relativ i lagështisë në ajër:* Ulja e nivelit të lagështisë kontribuon në tharjen dhe rritjen e aftësisë djegëse të materialeve organike pa jetë
  - *Koha që ka kaluar që nga reshjet e fundit dhe sasia e reshjeve:* Kjo përcakton nivelin e lagështisë dhe nivelin e thatësisë së materialeve të djegshme.

## Moti

Moti është ndoshta faktori dominues që ndikon në ecurinë e zjarreve në pyje. Përveç temperaturës së ajrit dhe nivelit të lagështisë, era është një faktor i rëndësishëm që ndikon në përhapjen e zjarreve:

- Shpejtësia e erës ka një ndikim të fortë në intensitetin e zjarrit, tek shpejtësia me të cilën ai përhapet dhe formësohet. Gjithashtu, era mund edhe të ngrejë në ajër thëngjijtë e t'i çojë përpara zjarrit kryesor, duke shkaktuar kështu vatra të tjera zjarri. Sa më e fortë të jetë era, aq më shpejt përhapet zjarri;
- Drejtimi i erës/ndryshimi i drejtimit është shumë i rëndësishëm për vlerësimin e ecurisë së zjarreve dhe për të vendosur se cila metodë apo procedurë evakuimi është më e përshtatshme për fikjen e zjarrit. Humbjet e jetëve njerëzore dhe pronave vijnë kryesisht nga ndryshimet e befta dhe të papritura të drejtimit të erës. Ndryshimet e drejtimit të erërave shkaktojnë ndryshimin e drejtimit të përhapjes së zjarreve. Këto ndryshime janë të rrezikshme nëse ndodhin në mënyrë të beftë dhe të papritur dhe mund t'i shndërrojnë disa zjarre relativisht të qetë në fronte aktive zjarri. Për këtë arsye, zjarrfikësit dhe drejtuesit e komuniteteve duhet të informohen vazhdimisht nga burime të besueshme në lidhje me parashikimin e motit dhe ndryshimin e pritshëm të drejtimit të erës.

## Topografia

Faktori i tretë i rëndësishëm që ndikon në riskun dhe përhapjen e zjarreve është topografia, sidomos në zonat malore:

- Pjerrësia: Zjarret me drejtimin nga poshtë lart përhapen më shpejt sesa zjarret me drejtimin nga lart-poshtë. Ndonëse zjarret që përparojnë poshtë një kodre apo mali përhapen ngadalë dhe mund të kontrollohen lehtë, zjarret që përhapen më drejtimin nga poshtë-lart digjen shumë shpejt dhe janë zakonisht të vështira për t'u kontrolluar. Zjarret që ngjiten sipër një kodre apo mali janë shkak i rëndësishëm i aksidenteve dhe fatkeqësive.
- Drejtimet e horizontit: anët jugore dhe perëndimore marrin më shumë diell dhe janë më të ngrohta e më të thata sesa ato veriore dhe lindore. Zjarret që digjen në këto shpate me diell përparojnë shumë më shpejt sesa ato në shpatet veriore dhe lindore të kodrave dhe maleve, sepse lënda e djegshme aty është më e thatë.

*Në lidhje me përgatitjen e “Planit për Mbrojtjen e Komunitetit nga Zjarret” (shih Pjesën 3.2), autoritetet lokale në zonat malore me ndërtesa apo fshatra në shpatet dhe në luginat e maleve, duhet të jenë të vetëdijshëm për rrezikun ndaj jetës së njerëzve dhe pronave në vende të tilla.*

## 2.4 Probleme specifike: Zjarret në tokat e kontaminuara

Në shumë vende të Rajonit të Ballkanit, ka zona pyjore dhe toka të tjera të kontaminuara nga lloje të ndryshme ndotësish industrialë, kimikë dhe radioaktivë ose nga mbetjet e konflikteve të armatosura si municionet e pashpërthyer dhe minat. Zjarret që bien në këto zona mund të çojnë në dëme anësore si ndotje kimike dhe radioaktive të ajrit dhe në shpërthime.

Aktivitetet për parandalimin apo shuarjen e zjarreve në terrene të tilla janë jashtëzakonisht të rrezikshme dhe kërkojnë ekspertizë dhe pajisje të specializuara. Banorët vendas që jetojnë brenda apo në periferi të zonave të tilla të kontaminuara duhet të udhëzohen në mënyrë të veçantë për mënyrën se si duhet të përballen me këto rreziqe.

Zonat e kontaminuara nga Mjetet e Pashpërthyer Vrasëse dhe nga minat e tokës duhet të shënohen si *Zona të Kuqe*, në të cilat duhet të kufizohen masat për parandalimin e zjarrit dhe fikja e zjarreve duhet të bëhet vetëm nga personeli i specializuar dhe me pajisjet e duhura. Shërbimet e administrimit të komunitetit dhe të zjarrfikësve kanë përgjegjësinë e shënimit të këtyre zonave me kufij të qartë dhe të dukshëm.

## 3. Përgatitja për Zjarret

Komunitetet rurale duhet të udhëzohen në mënyrë që të jenë të përgatitur për të mbrojtur shtëpitë, fermat dhe fshatrat e tyre nga zjarret. Një përgatitje e mirë do t'i bëjë komunitetet më rezistente ndaj zjarreve dhe do ta lehtësojë punën e zjarrfikësve në fikjen e zjarreve. Përgatitja për përballimin e zjarreve përfshin:

- Konsultimet me ekspertët dhe autoritetet lokale përgjegjëse për menaxhimin e zjarreve në pyje, toka bujqësore, rezerva natyrore, parqe kombëtare dhe vende të trashëgimisë natyrore/kulturore;
- Hartimin e një Plani të Komuniteteve për Menaxhimin e Zjarreve;
- Përpjekjet individuale për reduktimin e rrezikut të zjarrit në pronat private.

### 3.1 Mbledhja e aktorëve të interesuar dhe e vendimmarrësve

Në fillim të procesit të planifikimit, duhet të formohet një grup pune bazë i përbërë nga:

- Përfaqësues nga qeveria dhe administrata lokale, autoritetet e zjarfikësve dhe agjencitë shtetërore përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe për bujqësinë;
- Përfaqësues lokalë të fshatrave (të cilët duhet të identifikohen dhe të angazhohen aktivisht);
- Organizata dhe aktorë të tjerë të interesuar (të cilët duhet të nxiten për të marrë pjesë).

### 3.2 Plani i Mbrojtjes së Komunitetit nga Zjarret

Duke marrë parasysh faktorët që ndikojnë në ecurinë e zjarrit, siç përshkruhet në Pjesën 2, është e rëndësishme që të identifikohet në fillim risku nga zjarri që i kanoset komunitetit. Hartimi i një Plani për Mbrojtjen e Komunitetit nga Zjarri përfshin disa hapa me objektiva të ndryshme:

- Pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të banorëve vendas: Përfshirja e popullatës vendase në hartimin e Planit për Mbrojtjen e Komunitetit nga Zjarri krijon ndërgjegjësim rreth riskut nga zjarri, nxit pjesëmarrjen aktive dhe mund t'i bëjë pronarët e shtëpive dhe të tokave që të ndërmarrin përgjegjësi dhe të përgatiten për t'i mbrojtur pronat e tyre nga zjarri;
- Analiza e historisë së zjarreve të kaluara: Studimi i zjarreve të kaluara, shkaqeve dhe dëmeve në komunitet dhe në zonat përreth mund të çojë në përfundime të dobishme sa i përket asaj që duhet bërë dhe asaj që duhet shmangur para dhe gjatë kohës së përballimit të një zjarri.
- Vlerësimi i riskut: Identifikimi i zonave lokale me risk të lartë zjarri brendapërbrenda komuniteteve për të përcaktuar se cilat masa duhet të merren me përparësi për t'i parandaluar dhe për t'u përgatitur për zjarret që mund të bien.

#### **Historia e zjarreve dhe sezoni i zjarreve**

Konsultimi me të dhënat historike dhe përshkrimet e zjarreve të kaluara mund të lejojë një vlerësim të zgjeruar të shpeshësisë dhe periudhës kohore në të cilat kanë ndodhur zjarret në një zonë të caktuar

- Përmasave tipike të zjarreve;
- Llojeve kryesore të bimësisë që është djegur;
- Shkaqeve të zjarreve të kaluara.

Ky informacion do të ndihmojë për planifikimin e masave me synim reduktimin e rrezikut si nga ana gjeografike, ashtu edhe nga ana sezonale.

#### **Përgatitja e një Plani për Mbrojtjen e Komunitetit nga Zjarri**

*Përgatitja e një plani për menaxhimin e zjarreve në nivel komuniteti duhet të përfshijë pjesëmarrjen aktive të pronarëve/përdoruesve të tokave dhe të njerëzve që jetojnë në fshatrat apo vendbanimet afër tokave me pyje, shkurre dhe afër tokave bujqësore. Gjithashtu, duhet të inkurajohen që të marrin pjesë edhe organizata dhe aktorë të tjerë të interesuar.*

*Baza e një Planit për Mbrojtjen e Komuniteteve nga Zjarri është hartimi i një Harte për Menaxhimin e Zjarreve. Një metodologji për hartimin e një harte të tillë është ajo që quhet Ecje e Tërthortë, gjatë së cilës një specialist i menaxhimit të zjarreve, drejtuesit e komunitetit dhe banorët mbledhin informacione në terren. Gjatë kësaj Ecjeje të Tërthortë vlerësohen rreziqet nga zjarri dhe zonat më të prekshme, së bashku me topografinë e terrenit.*

Në hartë duhet të pasqyrohen këto informacione:

- Përshkrimi i karakteristikave të bimësisë: Harta duhet të përshkruajë llojin e materialeve të djegshme gjatë sezoneve të zjarreve, si p.sh. barin dhe shkurret në kullota të hapura, mbetjet bujqësore, pyjet, por edhe materialet e djegshme brenda apo në periferi të pemishteve. Vizitat në pyjet dhe kullotat që rrethojnë komunitetin gjatë një Ecjeje të Tërthortë do të krijojnë një ide rreth llojeve dominuese të bimësisë. Konsultimet me menaxherët lokalë të tokave, si me punëtorët e pyjores apo me ata që merren me planifikimin e terrenit ndihmojnë për të kuptuar disa veçori të bimësisë së rajonit, si për shembull sa shpejt rritet apo thahet bimësia dhe në cilën periudhë të vitit ndodhin këto procese

- Lidhja komunitet-bimësi: Vlerësimi i shtëpive, stallave, hangarëve, livadheve dhe aseteve të tjera që rrezikohen nga zjarri duhet të shohë edhe sa afër janë këto asete me bimësinë e djegshme

Pronarët e pronave dhe tokave duhet të bëhen të vetëdijshëm se janë përgjegjës për mbrojtjen e pronave të tyre duke marrë masa parandaluese ndaj zjarrit. Qeveria apo administrata lokale përcakton shkallën e riskut nga zjarri për të gjithë komunitetin dhe identifikon risqet dhe kufizimet e mundshme për zhvillim e ardhshëm në peizazhet të mbuluara me bimësi

- Terreni: Nëse një fshat, fermë apo shtëpi verore ndodhet në një terren të pjerrët, kërcënimet që vijnë nga zjarri janë shumë më të mëdha. Kjo ndodh veçanërisht me strukturat e ndërtruara në kreshta, shpate të pjerrëta dhe në gryka të pjerrëta. Këto zona mund të rrezikohen shumë për shkak të intensitetit të zjarreve që ngjiten nga poshtë-lart. Përveç kësaj, në terreni të tilla edhe mundësia për shërbime zjarrfikësish dhe mundësitë për t'i shpëtuar zjarrit mund të jenë të kufizuara ose mund të mos ekzistojnë fare

- Gjendja e rrugëve: Zonat me rrugë të pakëta dhe të ngushta mund të konsiderohen si më të rrezikuara në raste zjarresh, për shkak se rrëzimi i një peme mund të rrezikojë seriozisht mundësinë e banorëve për të shpëtuar dhe mundësinë e zjarrfikësve për të arritur te zjarri për ta fikur. Përveç kësaj, rrugët që përdoren rrallë mund të kthehen në itinerare jetësore transporti në raste zjarri. Kushtet në të cilat ndodhen këto rrugë duhen parë sidomos në periudhat para sezoneve kur ndodhen zakonisht zjarret.

Kjo hartë bazë tregon riskun nga zjarri të

- Llojeve të bimësisë
- Zonave pyjore dhe bujqësore të rrezikuara nga dëme të mëdha nga zjarret
- Shtëpive/fermave të vetmuara dhe të shpërndara nëpër terrenin rural
- Qendrave të banuara të komunitetit që ndodhen ngjitur me bimësinë rurale
- Infrastrukturave të tjera të rëndësishme
- Zonave të kontaminuara nga mjete të pashpërthyera vrasëse, mina apo landfille.

Banorët janë baza e parandalimit dhe planifikimit të përgatitjeve dhe harta mund të përdoret edhe nga zjarrfikësit gjatë fikjes së zjarrit. Harta mund t'i ndihmojë zjarrfikësit që të identifikojnë risqet gjatë përpjekjeve për shuarjen e zjarrit.

***Vlerësimi me të gjithë aktorët e interesuar: Përcaktimi me marrëveshje i prioritetëve***

*Drejtuesit e komunitetit duhet ta përdorin Planin e Mbrojtjes së Komunitetit nga Zjarri për të lehtësuar diskutimet bashkëpunuese me komunitetin që çojnë në identifikimin e prioritetëve lokale për reduktimin e materialeve të djegshme, aftësinë djegëse të strukturave dhe të çështjeve të tjera me interes, si përmirësimi i aftësive për t'iu përgjigjur zjarreve.*

*Pas finalizimit të planit të mbrojtjes, rezultatet i komunikohen komuniteteve dhe palëve dhe organizatave të tjera të interesuara. Autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e zjarreve duhet, gjithashtu, të kenë një kopje të Planit të fundit të miratuar të Mbrojtjes së Komuniteteve nga Zjarri para se të fillojë sezoni i zjarreve. Është madhe edhe më mirë nëse një përfaqësues i këtyre autoriteteve merr pjesë në hartimin e Planit.*

### 3.3 Realizimi i Parandalimit dhe Përgatitjes në Nivel Komuniteti

Gjatë zbatimit të Planit për Mbrojtjen e Komunitetit nga Zjarri, disa nga masat për Parandalimin dhe Përgatitjen në Nivel Lokal duhet të koordinohen nga qeveria vendore. Qeveria vendore është gjithashtu përgjegjëse për ofrimin e këshillave dhe orientimeve banorëve dhe për lehtësimin e marrjes së masave individuale nga pronarët e pronave private. Kjo punë duhet të bëhet në ato periudha të vitit kur risku i zjarreve është i vogël. Instruksionet e hollësishme teknike për pronarët individualë jepen në një libër të posaçëm udhëzimesh. Kështu, masat e mëposhtme teknike dhe organizative për parandalimin dhe përgatitjen në situata zjarresh janë ato për të cilat administrata lokale duhet të marrë përgjegjësi.

***Krijimi i zonave tamponë (buffer zone)***

Rritja e distancës midis bimësisë së djegshme dhe aseteve çon në uljen e riskut të marrjes flakë prej tyre në rast zjarresh. Krijimi i zonave tampon në të cilat bimësia dhe materialet lehtësisht të djegshme reduktohen ose hiqen krejtësisht, redukton intensitetin e zjarreve që afrohen (reduktimi i gjatësisë së flakëve dhe nxehësisë rrezatuese) dhe, rrjedhimisht, e ngadalëson ose e ndalon përhapjen e zjarrit. Në këto zona ta pastra tampon, është më e lehtë që të luftohet zjarri dhe të arrihet tek njerëzit e rrezikuar (p.sh. për t'i shpëtuar ose për t'i evakuuar).

*Prandaj, në varësi të llojeve të bimësisë që rrethon një fshat apo një shtëpi ose fermë, duhet të shqyrtohen me kujdes sa më poshtë:*

- Perimetrat e fshatrave duhet të pastrohen nga bimësia e imët deri në një distancë prej 25 metrash për të krijuar Zona Tampon për Mbrojtjen nga Zjarri, në të cilat bimësia e djegshme duhet të hiqet ose të reduktohet. Mund të lihen disa pemë, por duhet të jenë shumë të rralla dhe të krasitura. Të gjitha materialet bimore të thata në tokë duhet të hiqen rregullisht.

- Shtëpitë dhe strukturat e izoluara duhet të mbrohen nga një zonë e ngjashme tampon, por kjo është përgjegjësi e banorëve ose pronarëve
- Edhe kopshtet dhe hapësirat me bimësi brenda kufijve të një rezidence apo një prone tjetër duhet të mbahen të mbrojtura nga banorët ose pronarët
- Trojet bosh brenda zonave të zhvillimit rezidencial, në të cilat rritet bimësia e egër, duhet të pastrohen nga pronari i truallit ose nga qeveria vendore
- Rrugët mund të integrohen dhe të shfrytëzohen si zona tampon duke i pastruar nga bimësia e djegshme deri në një distancë prej 5-10 metrash në secilën anë.

### **Rrugët hyrëse**

*Rrugët hyrëse janë të nevojshme për të luftuar zjarrin dhe për evakuimin e banorëve vendas. Në zonat e zhvillimeve të reja, këshillohet që të gjitha shtëpitë dhe pronat të planifikohen që të kenë akses nga dy drejtime. Kjo redukton mundësitë e bllokimit të banorëve nga pengesat në rrugë.*

*Përveç kësaj, masat e mëposhtme përmirësojnë sigurinë e zjarrfikësve dhe të banorëve vendas:*

- Rrugët e të gjitha përmasave duhet të mirëmbahen në mënyrë që në to të mund të ecet me automjete dhe të mbahen gjatë gjithë kohës të lira, pa pengesa si për shembull pemët e rrëzuara. Kjo u jep akses më të mirë zjarrfikësve dhe më shumë mundësi shpëtimi civilëve në rast zjarri
- Emrat e rrugëve duhet të mbahen gjatë të gjithë kohës të qartë në tabela për të reduktuar konfuzionin gjatë aktiviteteve të mundshme për shuarjen e zjarreve
- Numrat e shtëpive duhet të jenë të dukshme lehtësisht dhe të ekspozuara mirë për të njëjtën arsye
- Parkimi duhet të mos lejohet në rrethrotullime dhe në rrugë të ngushta, në mënyrë që automjetet e emergjencës të mund të kalojnë lehtësisht
- Pemët që rriten në të dyja anët e rrugëve nuk duhet të pengojnë në asnjë mënyrë kalimin e automjeteve të emergjencës. Kjo do të thotë se ato duhet të jenë mjaftueshëm larg nga rruga dhe të krasitura në një lartësi prej 3-4 metrash nga toka
- Në intervale të caktuara të rrugëve të ngushta duhet të ketë xhepa të gjerë, ku të mund të shkëmbehen dhe të kthehen dy zjarrfikëse. Kjo është e nevojshme me qëllim shmangien e nevojës për manovrimë kthimesh të gjata dhe të komplikuar – një operacion që mund të rezultojë i rrezikshëm në rast zjarri
- Hidrante zjarri duhet të instalohen nëpër zonat e reja të zhvillimit, të cilat duhet të shtrihen deri në rrugët kryesore përtej kufijve të fshatrave. Kjo mundëson furnizimin me ujë të zjarrfikëseve pa qenë nevoja që ato të udhëtojnë distanca të gjata për ujë.

### **Pajisjet për raste emergjencash dhe mjete të tjera jo të specializuara kundër zjarrit**

Përveç pajisjeve të specializuara kundër zjarrit që përdoren nga zjarrfikësit profesionistë dhe vullnetarë, administrata lokale mund të ndihmojë në shuarjen e zjarrit duke mbështetur blerjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tjera për rastet e emergjencave si pompa uji, gjeneratorë, traktorë dhe depozita uji.

Ndonëse të jenë të përgatitur për shuarjen e zjarreve të strukturave/bimësisë, pothuajse e gjithë puna parandaluese mund të bëhet me mjete që mund të mos jenë projektuar posaçërisht për shuarjen e zjarreve.



Qëllimi kryesor i gjithë punës përgatitore kundër zjarreve të bimësisë është reduktimi i sasisë dhe vazhdimësisë së bimësisë lehtësisht të djegshme në afërsi të pronave, siç shpjegohet më sipër.

*Kjo mund të arrihet me mjete që variojnë që nga mjetet e thjeshta të dorës deri te makineritë e rënda –mjete që përdoren përgjithësisht për punët e përditshme bujqësore, mirëmbajtjen e rrugëve ose për punë ndërtimi – si private, ashtu edhe publike.*

- Mjetet e dorës që mund të përdoren për këtë qëllim përfshijnë –krehëra, shata dhe lopata.

Shtëpitë dhe fermat, ashtu sikurse edhe agjencitë lokale që menaxhojnë pyjet dhe parqet kanë shumë gjasa që t'i kenë mjete të tilla. Prandaj, mund të bashkëpunohet me to për të mos i blerë këto pajisje vetëm për këtë qëllim.

- Fermerët dhe pyjoret mund të kenë edhe sharra dhe mjete të tjera prerëse të fuqishme që mund të përdoren për këtë qëllim

- Për ndërtimin e brezave kundër zjarrit mund të përdoren makineritë e rënda që normalisht përdoren për funksione bujqësore, si traktorët ose plugjet e buldozerët.

Bashkëpunimi dhe koordinimi mes autoriteteve lokale, agjencive të menaxhimit të tokës dhe pronarëve të tokës për përdorimin e pajisjeve mund të lejojë marrjen e masave përgatitore me kosto të ulëta për të gjitha palët e përfshira.

### ***Përgatitjet për kufizimit të ndikimit të zjarreve***

Pavarësisht përgatitjeve më të mira të mundshme, ka shumë gjasa që një rajon që ka pësuar zjarre në të kaluarën të vazhdojë të pësojë zjarre sërish. Në këtë rast, masat e mësipërme do të jenë shumë më të thella sesa kufizimi i dëmeve të shkaktuara nga zjarret.

*Megjithatë, ka disa masa që mund të merren për të kufizuar ekspozimin e komunitetit ndaj zjarreve duke përmirësuar përgatitjet në nivel organizativ.*

- Plani i komunikimit: Të gjitha mjetet teknike që ekzistojnë sot duhet të përdoren për të përgatitur një sistem paralajmërimi për informimin e banorëve rreth sitave të rrezikshme të zjarrit. Duke qenë se telefonat celularë po bëhen gjithmonë e më të zakonshëm edhe në zona të largëta rurale, duhet menduar krijimi i një sistemi paralajmërimi të komunitetit në raste emergjencash (me SMS)

- Hotline: Përveç numrave kombëtarë të telefonit për rastet e emergjencave (p.sh., 112) anëtarët e komunitetit duhet të kenë edhe mundësi të telefonojnë administratën lokale për të dhënë informacion në lidhje me situata zjarri ose për të marrë udhëzime për atë çka duhet të bëjnë në raste zjarri.

- Plan Emergjencash: Duhet të hartohet një plan emergjencash në raste zjarresh të mëdha. Ky plan duhet të përfshijë edhe masat përgatitore për evakuimin dhe për strehimin e sigurt.

### **Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar personave me aftësi të kufizuara:**

Personat me aftësi të kufizuara dhe shumë prej individëve që nuk janë në gjendje të evakohen vetë, të shohin rrezikun që u afrohet apo që t dëgjojnë thirrjet për evakuim janë shumë të prekshëm nga zjarri. Personat që kanë probleme me shikimin dhe dëgjimin nuk janë në gjendje të dëgjojnë njoftimet në radio apo të shohin lajmet lidhur me to në televizor.

Përveç kësaj, ata zakonisht nuk janë në gjendje që të drejtojnë makinën dhe të evakohen siç duhet.

Përgatitjet në nivel komuniteti përfshijnë edhe:

- Plane emergjencash me njoftime për shtyp dhe broshura të përditësuara që lidhen me hapat që duhet të ndërmarrin personat me aftësi të kufizuara për t'u përgatitur për zjarret dhe për evakuim
- Numra telefoni dhe sisteme paralajmërimi që u japin mundësi subjekteve publike që të kenë lista të personave që mund të kenë nevojë për asistencë të specializuar në raste emergjencash ose evakuimi
- Programe vullnetarësh që mund t'i ndihmojnë individët gjatë evakuimit kur ata nuk janë në gjendje që të evakohen vetë
- Programe të sigurisë publike që mund t'i ndihmojnë individët me aftësi të kufizuara në bërjen e një vlerësimi të shtëpive të tyre sa i përket sigurisë
- Një listë të rekomanduar të objekteve më të rëndësishme që duhen evakuuar në raste emergjencash, në mënyrë që njerëzit t'i kenë ato gati në rast evakuimi
- Media televizive me njoftime në raste emergjencash në kohë reale.